



Schulzahnärztlicher Dienst

Pse duhet t'i mjekoni dhëmbët tuaja të prishur

Në shumicën e rasteve dhëmbët e prishur i sheh vetëm dentisti, shpesh pasi që i ka fotografu në rentgen. Një person normal kur e sheh vrymën në dhëmb, atëherë është shumë vonë. Për këtë shkak është e udhës që një herë në vit të kontrollohen dhëmbët te dentisti.

Gesundheitsdepartement
Davidstrasse 27
9001 St.Gallen
T 058 229 43 82
F 058 229 35 52
gesundheitsvorsorge@sg.ch
www.gesundheit.sg.ch

Pasoja e dhëmbëve të pa kontrolluar:

Dhëmbët e qumshtit

- Dhëmbët e prishur të qumshtit shkaktojnë dhimbje masive, probleme të cilat pengojnë fortë kualitetin jetësorë (Pagjumsijë etj.)
- Dhëmbët e prishur të qumshtit mund të shkaktojnë **grumbullim të qelbit** të shoqëruar nga temperatura që mund të çojnë eventualisht edhe deri te **dëmtimi i organeve të tjera të trupit**. Është e mundur që personi të obligohet të shtrihet në spital dhe në rast edhe më të rëzëshëm ti kanoset jeta.
- Humbja e dhëmbëve të qumshtit në kohët e hershme çon deri te **pengimi në zhvillimin e eshtrave** të nofullës. Dhëmbët e afërt afrohen te shprastirat dhe pengimi i rregullimit të dhëmbëve është i pamundshëm. Në këta raste duhen **operime** ose mjekime ortodontike (mbajtse tërthore të dhëmbëve) harxhimet e të cilave janë shumë të mëdha.

Dhëmbët normal

- Që të pengohen vrymat duhet të mbushen vendpërtpjet (dhëmbët)
- Sa më e **vogël** të jetë **vryma**, aq më **lehtë** dhe me **lirë** është reparimi i tyre. Dhëmbi kështu mund të mbahet më gjatë.
- Nëse vonohet shumë mjekimi, mund të paraqiten **dhimbje të rënda**. Pasojë e cila mund të çojë deri te **mjekimi i thellë i rrënjave** të dhëmbit ose edhe **nxjerja** e dhëmbit.
- **Humbja e dhëmbëve ka pasoja negative në pamjen e jashtme** (estetik/humbja e kockës së nofullës)

Pasoja tjera të mundshme:

- Pengesa në funksionimin e nofullës, **dhimbje të nyjeve**, pengesë në funksionin e të folurit
- **Lëvizja e dhëmbëve** kah shprastirat me mundësi të **pengesës së funksionimit**
- **Grumbullimi i qelbit** me infektim të rëndë të vendit dhe me infektim të përgjithshëm, në rast ekstrem rezikon jetën
- **Dëmtimi i organeve tjera të trupit** p.sh. zemra, veshkët, mushkëritë, sytë etj.

☞ **Kontrolloni dhëmbët vehtes ose fëmiut tuaj rregullisht te një dentis.** Mos e friksoni fëmiun tuaj nga dhimbjet e rënda që i bën dentisti gjatë mjekimit të dhëmbëve, por ndihmoni dhe mësonie si të mbijetoj dhimbjen.

☝️ **Rruga më e mirë që i menjanon këta shqetsime është parandalimi ngrënjes së tepërt të ëmbëlsirave, higjiena e gojës dhe flouridi (pastrimi i gurit në gojë) i rregullt.**

Kjo fletësh mund te meret falas te adresa e sipërshënuar.